

VENDIM
Nr. 754, datë 13.12.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 518, DATË 20.9.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË NJË PJESE TË GODINËS, KU USHTRON VEPRIMTARINË KONTROLI I LARTË I SHTETIT, PËR KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT DHE KOMISIONERËVE PUBLIKË, INSTITUCIONE TË RIVLERËSIMIT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, I PARASHIKUAR NGA LIGJI NR. 84/2016”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në titullin e vendimit nr. 518, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës, ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe Komisionerëve Publikë, institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga ligji nr. 84/2016”, të ndryshuar, dhe kudo në përmbajtje të këtij vendimi, fjalët “... Komisionerëve Publikë, institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga ligji nr. 84/2016” zëvendësohen me “... Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2025.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku